



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E
SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE
MEDIUMET ELEKTRONIKE***

16 - 18 Janar 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Mjeku Taravari: Simptomat e para nga ndotja e ajrit, shfaqen më vonë

Shkup, 18 janar - Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, në veçanti ata të Tetovës, Shkupit dhe Manastirit, ka një kohë të gjatë që thithin ajër të ndotur, i cili në raste të veçanta për disa herë kalon nivelin e lejuar, gjë të cilën e dëshmojnë edhe stacionet matëse të ajrit. Mirëpo ajo që nuk është trajtuar aq sa duhet është shfaqja e simptomave të para nga thithja e ajrit të ndotur, raporton Anadolu (AA).

Lidhur me këtë dukuri shqetësuese në një bisedë për Anadolu Agency (AA) mjeku dr. Arben Taravari nga Klinika Universitare në Shkup thotë se parametrat e ajrit, të cilat përmbajnë grimca të quajtura 'PM 10', të cilën Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka cilësuar si kancerogjene, në Tetovë dhe në Shkup tejkalon për disa herë nivelin e lejuar.

Sipas tij, në vitin 2010 ka patur rreth 1300 persona të sëmurë nga kancere të ndryshme, kurse në vitin 2013 kjo shifër gati se është dyfishuar, ndërsa siç thotë ai, nuk ka shifra zyrtare për vitet 2014 dhe 2015.

Taravari sqaron se ndotja e ajrit nuk shkakton probleme vetëm tek sistemi respirator, ashtu siç mendohet fillimisht.

"Më së shumti ndikon në organet e frymëmarrjes, kurse organet e frymëmarrjes e kanë për obligim që oksigjenin që e marrin nga ajri, ta dërgojnë nëpër organe të tjera kështu që kryejnë probleme edhe në veshkë, në sy dhe në tru. Në shumë sisteme organike ndikojnë negativisht", deklaroi për AA mjeku Taravari, sipas të cilit në një afat të shkurtër nuk mund të ndjehet asgjë, por disa njerëz të cilat janë më të ndjeshëm, mund ta ndjejnë në forma të ndryshme.

"Në afat të shkurtër nuk mund të ndjehet asgjë, por disa njerëz të cilat janë shumë të ndjeshëm mund ta ndjejnë në mënyrë të teshjes dhe kollitjes, e disa me ndryshime të ngjyrës së lëkurës, me ndryshime në konjunktivën e syrit, por në përgjithësi këto nuk ndihen menjëherë. Pasojat e ndotjes së ajrit që ndodh momentalisht në Maqedoni do të vërehen vite me radhë, d.m.th. nëse i analizojmë çdo vit rastet me kancer dhe i krahasojmë me vitet e kaluar, do të shikojmë një rritje drastike", deklaroi Taravari.

Ndryshe, organizatat joqeveritare të ndryshme të tubuara nën platformën "Dil për ajër të pastër" mbrëmë para godinës qeveritare në Shkup kërkuan nga organet kompetente të ndërmarrin masa urgjente për parandalimin e ndotjes së ajrit. Protestuesit thonë se nëse qeveria nuk ndërmerr masa deri më 15 janar, ata do t'i bllokojnë rrugët kryesore të qyteteve të ndotura.

Ditë më parë qeveria miratoi konkluzat me të cilat u rekomandoi të gjitha subjektet juridike në qytetin e Shkupit dhe komunën e Tetovës t'i lirojnë nga obligimet e punës gratë shtatzëna, personat mbi moshën 60 vjeçare me sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe personat nën moshën 60 vjeçare me diagnozë



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



të astmës dhe sëmundjes kronike obstruktive të mushkërive të bardha deri më 4 janar.

Qeveria e Maqedonisë u rekomandoi qytetit të Shkupit dhe komunës së Tetovës t'i intensivikojnë aktivitetet për pastrimin e rrugëve, veçanërisht rreth kopshteve.

Sezoni i gripit, kumanovarët dhe tetovarët prijnë

Tetovë, 16 janar- 1525 është numri i përgjithshëm i rasteve të sëmurë nga gripi për këtë sezon. Pjesa dërmuese e këtij numri të sëmurëve gjendet në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep, transmeton zhurnal.mk

“Kushtet e motit dhe temperaturat e ulëta ndikojnë në shëndetin e njeriut, që si rezultat i shpeshtë janë infeksionet respiratore, ftohje të vogla, zvogëlimi i rezistencës.

Gjatë ndryshimit të motit ftohtë-nxehtë zvogëlohet forca mbrojtëse imunitare e organizmit kështu që jemi më të ekspozuar ndaj infeksioneve tjera duke përfshirë edhe gripin.

Tani kushtet e motit janë të përshtatshme për gripin dhe presim që numri të rritet në javët e ardhshme”, deklaroi Gordana Kuzmanovska nga Instituti i Shëndetit Publik, transmeton zhurnal.mk

Banesat pa ashensorë, vështirësi për personat me nevoja të posaçme

Shkup, 18 janar - Njëzet e njëvjeçari Muaz Mehmeti nga Buteli i Shkupit ka tetë vite që është i lidhur me karrocën e tij. Ai që nga lindja vuan nga diagnoza mjekësore “hidocepalus”, ndërkaq me kalimin e viteve i është paraqitur edhe epilepsia.

Ai një kohë të gjatë nuk kishte pasur mundësi të dal jashtë, për shkak se jeton në një banesë në katin e dytë në një ndërtesë banimi pa ashensor. Por një bamirës atij i mundësoi rregullimin e një ashensori të improvizuar, dhe kështu Muazi kishte shijuar parkun para ndërtesës së banimit, pas dy viteve sa ishte i ngjuar në banesë. Por më pas ky ashensor i sjellë telashe, për shkak të harxhimit të madh të energjisë elektrike dhe faturave të papërballueshme.

E Muazi thotë se vështirë e ka që të përballojë gjendjen e tanishme dhe problemet e krijuara.

“Me nënën time dal por vetëm verës. Jo dimrit nuk dal shpesh. Nuk dal për shkak se është ftohtë. Verës më së shumti dal në park. Mos të kishin ndreq këtë lift, kisha mbet këtu i mbyllur”, shprehet ai.

Babai i tij, Agim Mehmeti thotë se është i detyruar që të rrijë në shtëpi për tu kujdesur për djalin e tij. Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë 150 euro, që i merr gruaja e tij. Por shumë para shkojnë për ilaçe.

“Kohë pas kohe, edhe shkon duke u rëndu peshë e tij. Gruaja ime nuk mund ta mbajë. Por, unë jam ai që duhet të jam me atë. Si në haje, si në veshje, në pastrim, në shëtitje. Është i liruar nga partipacioni i ilaçeve



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



nga shteti por shtesën e ilaçeve e paguan. Ilaçin që e merr është afër 5 000 mijë që do të thotë afër 80 euro. Për ta paguar këtë çmim, për ne është shumë”, thotë babai i Muazit, Agim Mehmeti.

E përveç kësaj, faturat e larta të energjisë sidomos për shkak të ashensorit kanë rënduar ndjeshëm jetën e kësaj familje. Agimi thotë se faturat e energjisë u vijnë deri në 5 mijë denarë. E këto situata të papërbalueshme, këtë familje para një muaji e lanë pa energji elektrike, për shkak të borxhit. Muazi dhe prindërit e tij kërkojnë ndihmë dhe lehtësim të kushteve, sidomos nga EVN Maqedoni. Zëdhënësja e kësaj kompanie, Vlera Gjakova thotë se ofrojnë mundësinë e pagesës së borxheve përmes kësteve.

“Borxhin që e ka duhet patjetër ta paguajë. Këto ligje vinë edhe nga organet kompetente dhe në këtë rast Komisioni Rregullator energjetik. Ne kemi ofruar pagesë me këste dhe urojmë që në të ardhmen të nënshkruhet kontrata dhe të zgjidhet çështja”, thotë Vlera Gjakova.

Përndryshe në Maqedoni ka gjithsej 10% prej fëmijëve me nevoja të posaçme me shkallë të lartë të invaliditetit fizik dhe mendor. Sipas organizatave joqeveritare diskriminimi i personave me invaliditet është më i theksuar. (TV21)



Mjekët alarmojnë për rritje masive të të sëmurëve nga gripi, numri me i madh Tetovë, Gostivar dhe Prilep



Moti i nxehtë dhe i ftohtë, që është një karakteristikë e këtij dimri, ndikon në uljen e imunitetit. Mjekët në Maqedoni thonë se për shkak të ndryshimit të motit zvogëlohen fuqitë mbrojtëse të organizmit dhe për këtë arsye te shumë qytetarë paraqiten infeksionet respiratore dhe gripi.

shumë se javën para saj.

Javën e kaluar numri i personave të paraqitur me simptoma të gripit ka arritur në 277, që është për rreth 70 për qind më

“Kushtet e motit dhe temperaturat e ulëta ndikojnë në shëndetin e njeriut, që si rezultat i shpeshtë janë infeksionet respiratore, ftohje të vogla, zvogëlimi i rezistencës. Gjatë ndryshimit të motit ftohtë-nxehtë



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



zvogëlohet forca mbrojtëse imunitare e organizmit kështu që jemi më të ekspozuar ndaj infeksioneve tjera duke përfshirë edhe gripin. Tani kushtet e motit janë të përshtatshme për gripin dhe presim që numri të rritet në javët e ardhshme”, tha Gordana Kuzmanovska, Instituti i Shëndetit Publik.

Numri i përgjithshëm i rasteve të sëmurë nga gripi këtë sezon është 1525, ndërsa numri më i madh i të sëmurëve është në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep.

“Për këtë periudhë vazhdimisht përpunohen ndryshimet dhe gjat ë ndryshimit më intensiv që ndodh në atmosferë caktohet një indeks dhe përcaktohen vështirësitë që njerëzit do ti ndjejnë”, tha Boris Sekirarski, sinoptikan.

Parashikimi i meteorologjisë mjekësorevlen për 60 orë, dhe kur moti është me diferenca të mëdha temperaturash indekset tregojnë se njerëzit ndjejnë vështirësi më të mëdha shëndetësore.



Ndotja e ajrit, grimcat PM-2.5 më të rrezikshme se PM-

10



industria, qymyri dhe pluhuri i bartur nga era.

Në ajrin e ndotur në vend, përveç grimcave të njohura si të rrezikshme PM10, qarkullojnë grimca edhe më të vogla dhe më të rrezikshme. Bëhet fjalë për grimcat PM 2.5. Sipas ekspertëve këto grimca janë shumë më të rrezikshme për shkak se në mënyrë direkte dhe shumë shpejt e sulmojnë sistemin e frymëmarrjes. Këto grimca të vogla Ministria e Mjedisit jetësor i mat vetëm në dy komuna të vendit edhe atë në komunën Qendër dhe Karposh. PM 2.5 kanë formë aerodinamike dhe janë një produkt i djegies nga

"Këto PM grimca kanë mundësinë të depërtojnë shumë thellë në epitelin respirator, ose përmes mukozave të epitelit respirator dhe rrugëve të frymëmarrjes të depërtojnë në pjesët më të imëta", tha Biserka Qaeva, drejtoreshë e Klinikës së Pneumologjisë.

Në rrezik të veçantë nga këto grimca janë gratë shtatzëna, të sëmurët kronik dhe fëmijët.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk




"Fëmijët e vegjël janë vazhdimisht në lëvizje dhe tek ata ajri i thithur është shumë më i madh për kilogram të peshës trupore se sa tek të rriturit. Prandaj dëmi nga PM grimcat apo gazrat e dëmshme është shumë më i dëmshëm", u shpreh Biserka Qaeva, drejtoreshë e Klinikës së Pneumologjisë.

Ekspertët po ashtu tërheqin vërejtjen se pak njerëz e dinë se duhet të shmangët dalja kur ka diell, ndërsa ajri është më i ndotur, sepse atëherë krijohet ozon në shtresat më të ulëta të ajrit. Ndryshe javën e kaluar, numri i personave që kanë kërkuar ndihmë në klinikën e Pneumologjisë është rritur, dhe për dallim nga periudha para Vitit të Ri, kur ka pasur vende të lira, tani kërkohet një krevat plus. Probleme më të mëdha kanë njerëzit me sëmundje kronike obstruktive, bronkit kronik dhe astmë.



Gjithsej 1.272 thirrje në "Alo doktor" për një javë



Javën e kaluar, nga 11 deri më 17 janar janë rregjistruar gjithsej 1.272 thirrje në linjën telefonike për këshillë mjekësore "Alo doktor"...

Siç informoi EPSH Shtëpia e Shëndetit - Shkup, thirrjet janë nga qytetarë nga të gjithë qytetet e Maqedonisë. Paraqitjet janë më së shpeshti për simptome respiratore, shtypje e lartë e gjakur, temperaturë të rritur trupi, ftohje dhe kollitje të shkaktuara nga moti i ftohtë.

Në linjën telefonike 02/15 123 nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja, deri më tani, ka pasur 72.062 thirrje.

"Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtëprëdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të çrregullimit të shëndetit. Për qytetarët janë në dispozicion gjithsej 25 mjekë, kumtoi Shtëpia e Shëndetit - Shkup.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatike./Mia



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Kumanovë: Mbi 80 fëmijë të prekur nga “Variçela”



Në qytetin e Kumanovës mbi 80 fëmijë janë prekur nga “Variçela” apo e njohur në popull si “lija e dhenëve”...

Janë këto të dhëna të Qendrës së shëndetit publik në Kumanovë edhe atë vetëm për pjesën e dytë të muajit dhjetor të vitit të kaluar, kurse pritet që gjatë dy javëve të para të këtij viti numri i të prekurve të jetë edhe më i madh.

Epidemiologja Jadranka Stamenkovska, në një prononcim për gazetarë tha se sëmundja është sezonale dhe kryesisht i prek fëmijët.

Në Qendrën e shëndetit publik në Kumanovë gjatë muajit dhjetor janë evidentuar 86 fëmijë nga “Variçela” apo lija e dhenëve.

Ky numër në krahasim me muajin e kaluar shënon rritje të dukshme.

Stamenkovska thotë se fëmijët e prekur nga kjo sëmundje duhet ti nënshtrohen terapisë, kurse përshkak të mos bartjes së sëmundjes tek fëmijë të tjerë duhet të qëndrojnë në shtëpi.

Kumanovë Masa kryesore preventive është izolimi në masa shtëpiake, respektivisht mjekimi duhet të bëhet në kushte shtëpiake, fëmiju nuk duhet të shkojë në shkollë apo në çerdhe.

Rrethanë lehtësuese është se aktualisht nxënësit janë në pushim dimëror që gjithsesi ndikon në moszgjerimin e Variçelës në përmasa më të gjera.

Ndryshe më të prekur janë fëmijë të mjedisit urban për dallim të atyre nga midiset rurale.